



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

ANALIZË PUNE PËR VITIN 2024



Tiranë 2025

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJA	3
II.	HYRJE	3
2.1	Misioni	3
2.2	Detyrat	3
2.3.	Struktura	4
III.	QËLLIMI DHE METODOLOGJIA	4
IV.	ARRITJE TË ISHMT-SË	5
V.	INSPEKTIMET DHE RAPORTIMET SIPAS DREJTORIVE	8
5.1	DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE (DMP)	10
5.1.1	Inspektimi Metrologjik	10
5.1.2.	Produkte elektrike.....	11
5.1.3.	Produkte mekanike	12
5.1.4	Qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme.....	14
5.2	DREJTORIA E PRONËSISË INTELEKTUALE	16
5.2.1	Inspektimi mbi të drejtën e autorit	16
5.2.2	Inspektime mbi pronësinë industriale.....	17
5.3.	DREJTORIA TEKNIKE	17
5.4.	DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	21
VI.	PUBLIKIME & AKTIVITETE SENSIBILIZUESE	25
VII.	PROBLEMATIKA TË HASURA	28
VIII.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	31
IX.	OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025	32
X.	ANEKS	34

I. PËRMBLEDHJA

Raporti mbi veprimtarinë e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) përmban në mënyrë të përmbledhur një analizë të punës së kryer nga ky institucion për vitin 2024, duke përfshirë inspektimet mbi kontrollin e zbatimit të kriterëve ligjore nga subjektet, sipas fokusit të çdo sektori/drejtorie , aktivitetet sensibilizuese, informuese, trajnime e seminare. Gjithashtu në këtë raport janë paraqitur edhe problemet me të cilat është përballur ISHMT-ja gjatë këtij viti, ku, mund të përmendim si më të rëndësishme për mbarëvajtjen e përditshme të punës: mungesa e mjeteve të transportit, mungesë eksperience e stafit, etj., ndërsa për sa i përket procesit të inspektimit , evident ka qenë mos plotësimi i planit të inspektimit me 23 % për shkak të angazhimit të ISHMT-së në fusha të reja inspektimi të diktura nga situata të veçanta si: monitorimi dhe inspektimi i qeseve plastike mbajtëse , mosgjatja e subjekteve në adresë etj.

Në këtë raport janë paraqitur edhe rekomandime për përmirësimin e punës dhe të marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërinstytucional që do të ndikojnë në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së punës së këtij institucioni dhe të një mirëkoordinimi me institucionet e tjera publike, grupet e interesit dhe operatorët ekonomikë.

II. HYRJE

2.1 Misioni

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është një institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë dhe me seli në Tiranë¹.

ISHMT-ja ka për mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi. ISHMT-ja është, gjithashtu, përgjegjëse për të monitoruar respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale, objekt inspektimi sipas këtij vendimi.

2.2 Detyrat

Në zbatim të VKM-së nr.36 datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT”, i ndryshuar, fushat e përgjegjësisë së ISHMT-së janë si mëposhtë:

- a) mbrojtja e konsumatorëve, sipas përcaktimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- b) mbrojtja e pronësisë industriale, sipas përcaktimit të legjislacionit për pronësinë industriale;
- c) garantimi i mbrojtjes dhe i respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas përcaktimit të legjislacionit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të

¹ VKM Nr.36, datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT”.

lidhura me to;

- ç) inspektimi metrologjik, sipas legjislacionit për metrologjinë;
- d) etiketimi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, sipas përcaktimit të legjislacionit për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji;
- dh) kontrolli i detergjentëve të vendosur në treg sipas dispozitave të ligjit për detergjentët;

2.3.Struktura

ISHMT-ja organizohet si Drejtoria e Përgjithshme me juridiksion në të gjithë territorin e vendit. Struktura dhe organika e re e ISHMT-së është miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.73, datë 01.06.2020 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”.

ISHMT-ja përbëhet nga 4 drejtori:

1. Drejtoria Teknike
2. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve
 - 2.1.Sektori i Produkteve Elektrike
 - 2.2.Sektori i Inspektimit Metrologjik
 - 2.3.Sektori i Produkteve Mekanike
 - 2.4.Sektori Kimik dhe i Sigurisë së Përgjithshme
3. Drejtoria e Pronësisë Intelektuale
 - 3.1.Sektori i Pronësisë Industriale
 - 3.2.Sektori i të Drejtës së Autorit
4. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
 - 4.1. Sektori Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse
 - 4.2.Sektori i Financës

III. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

I.1 Qëllimi

- ✓ Ndjekja e procedurave të inspektimit me rigozitet dhe konform legjislacionit në fuqi.
- ✓ Evidentimi i pikave të dobëta në punën e ISHMT-së duke krijuar premisa për marrjen e masave për përmirësimin e tyre në të ardhmen.
- ✓ Evidentimi i risqeve dhe marrja e masave për minimizimin ose eliminimin e tyre.
- ✓ Evidentimi i problematikave, marrja e masave dhe nxitja e mekanizmave për zgjidhjen e tyre duke rritur cilësinë e punës së këtij institucioni.

I.2 Metodologjia

Metodologjia e ndjekur për hartimin e këtij raporti mbi punën e kryer nga ISHMT-ja për vitin 2024 bazohet në :

- ✓ Analizën e raporteve periodike të dorëzuar nga çdo sektor në lidhje me punën e kryer në terren (inspektime), problematikën e hasur dhe sugjerimet për përmirësimin në vazhdimësi;
- ✓ Përpunimin e statistikave të mbledhura mbi inspektimet e kryera nga inspektorët gjatë kësaj periudhe kalendarike ;
- ✓ Feedback-un nga aktorë të ndryshëm (publikë, privatë, ndërkombëtarë) me përvojë dhe eksperiencë në fushat që janë në fokusin e punës së ISHMT-së;
- ✓ Analizën e procedurave të inspektimeve, të performancës, proceseve gjyqësore, trajtimit të ankesave etj ;
- ✓ Analizën e trajtimit në kohë dhe me profesionalizëm të ankesave të depozituara pranë ISHMT-së nga konsumatorë, operatorë ekonomikë apo institucione shtetërore.

IV. ARRITJE TË ISHMT-SË

- ✓ Ndikimi në uljen e mos-konformiteteve të produkteve joushqimore si dhe në respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit 2024. Inspektimet e vazhdueshme dhe të rregullta në treg, të shoqëruara nga fushata sensibilizuese, kanë ndihmuar në përpjekjet institucionale për të arritur këtë objektiv. Janë kryer në total **2983 inspektime** nga të cilat 2796 inspektime të programuara² dhe 187 jashtë programit mbi bazë ankimi³. Janë vendosur **109 masa administrative në total** nga të cilat 5 paralajmërime, 101 gjoba dhe 3 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar **8684 produkte** nga të cilat 118 produkte kanë qenë jo në konformitet.
- ✓ Hartimi i “PLANI I INFORMIMIT DHE KËSHILLIMIT TË SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT DHE KONSUMATORËVE QERSHOR – DHJETOR 2024”, i mbështetur në “Strategjinë Ndërsektoriale Për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut” 2024 – 2030, ku si rrjedhojë janë organizuar fushata informuese/ndërgjegjësuese për **qeset plastike mbajtëse që përdoren gjatë aktivitetit tregtar dhe tregtimin e bukës dhe prodhimeve të brumit**. Në funksion të kësaj fushate janë hartuar edhe formate njoftimi/këshillimi për subjektet, në mënyrë që të njihen me kërkesat ligjore që duhet të përmbushin gjatë tregtimit.

²² “Inspektim i programuar” është inspektimi që kryhet në bazë të programit të miratuar të inspektimit për çdo inspektorat qendror apo vendor

³Inspektim jashtë programit konsiderohet inspektimi kur: a)nga monitorimi dhe mbikëqyrja e kryer nga inspektorai , nëpërmjet analizës periodike dhe të vazhduar të të dhënave apo informacioneve, lind dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore; b) ndodhja e ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve kanë cenuar apo mund të cenojnë jetën ashëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin; c) si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik shqiptar apo një shtet tjetër a njëorganizatë ndërkombëtare.; d) në bazë të një denoncimi apoinformacioni të marrë nga të tretët, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nganjë subject; e)në kushtet e flagrancës; etj.

- ✓ Publikimi rregullisht i informacioneve mbi veprimtarinë kontrolluese të ISHMT, me të dhëna të dobishme për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë. Si rezultat i publikimeve të shpeshta, deri në periudhën shtator 2024, kemi rritjen e numrit total të vizitorëve me 39.2% dhe për vizitorët e rinj numri u rrit me 106%.
- ✓ Informimi i konsumatorëve mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurta dhe informimin e operatorëve ekonomikë, për të respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara në legjislacionin aktual, për të ofruar në treg produkte të sigurta si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Kjo është arritur nëpërmjet aktiviteteve, trajnimeve të ndryshme të organizuar me pjesëmarrjen e grupeve të interesit, të botimeve dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve, botimeve informuese etj. Në total janë realizuar **10 aktivitete/fushata sensibilizuese**.
- ✓ Me qëllim përmirësimit të veprimtarisë institucionale nëpërmjet evidentimit të problematikave, adresimit të tyre dhe marrjen e iniciativave për rritjen e nivelit të mbikëqyrjes së tregut, ISHMT hartoi databazën ligjore që lidhet me fushën e veprimtarisë së ISHMT. Në këtë databazë janë evidentuar dhe pasqyruar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që janë nën zbatimin e ISHMT duke identifikuar edhe aktet e BE të cilat ato përafrojnë. Në këtë seksion përfshihen edhe komentet për aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me problematikën në zbatimin e tyre, propozimet ku mund të bëhen ndërhyrje/ndryshime në akt si dhe nivelin e përafritimit me Acquis e BE. Për çdo akt ligjor dhe nënligjor, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, janë evidentuar dhe janë hedhur në databazë standardet shqiptare të harmonizuara që shërbejnë për prezumimin e konformitetit të produkteve joushqimore (kur janë të zbatueshme). Në këtë seksion janë përfshirë standardet të cilat mund të mos jenë bashkëlidhur aktit ligjor/nënligjor në momentin e publikimit në fletoren zyrtare, por që janë të rëndësishme për prezumimin e konformitetit të produkteve përkatëse, si dhe komentet për standardet që nënkupton nëse lind nevoja për përditësimin e tyre referuar ndryshimeve ligjore.
- ✓ U hartua urdhëri “Për unifikimin e praktikave të mbikëqyrjes së tregut dhe inspektimit”, i cili unifikon afatet për strukturat inspektuese të ISHMT në respektim të plotë të kuadrit ligjor dhe synon menaxhimin sa më korrekt të procedurës administrative të inspektimit. Urdhëri hyri në fuqi më datë 1 dhjetor 2024.
- ✓ Fuqizimi i ISHMT-së dhe rritja e kapaciteteve njerëzore. Gjatë kësaj periudhe janë kryer në total **27 trajnime të stafit në** fushën e mbikëqyrjes së tregut, pronësisë intelektuale dhe burimet njerëzore . Trajnimet janë mbështetur nga donatorë të ndryshëm, ASPA etj.

- ✓ ISHMT është bërë pjesë e sistemit të shkëmbimit të informacionit të produkteve jo të sigurta, që njoftohen nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut të vendeve palë të Marrëveshjes Qëndrore Evropiane të Tregtisë së Lirë, mbëstetur nga CEFTA dhe GIZ.
- ✓ ISHMT në vitin 2024 ka qene pjesë e GPNIE jo vetëm për raportimet për Kapitullin 1, 7 dhe 28 si në vitin 2023 , por është angazhuar edhe në raportimet për nënkapituj të veçantë të Kapitujve 15, 12, 27, 14.
- ✓ Në kuadrin e ofrimeve të shërbimeve on-line për publikun dhe subjektet , ISHMT vijon komunikimin me AKSHI për finalizimin e ofrimit në portalin e-albania të shërbimit : Pajisja me Çertifikatë regjistrimi të ashensorit; e cila do të sjellë shkurtim të proceseve administrative dhe lehtësim për të gjithë palët e interesuara.
- ✓ Në 2024 janë hartuar dhe miratuar listë verifikimet për pajisjet e gazit dhe për enët e thjeshta nën presion, ku ISHMT nisi për herë të parë inspektimet për këto grup produkte. Ky zhvillim ka impakt pozitiv edhe në procesin e raportimit në nënkomitete Shqipëri-BE mbi veprimtarinë inspektuese të ISHMT.
- ✓ Janë nënshkruar 2 marrëveshje bashkëpunimi dhe përkatësisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit.
- ✓ ISHMT-ja përgjatë vitit 2024 ka përgatitur dhe ka miratuar Rregulloren e Komisionit të Ankimit.
- ✓ ISHMT si pjesë e task-forcës në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 35, datë 19.02.2024 "Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Task- Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe të qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme”, ka realizuar takime me perfektët e Prefekturave, ku përmendim: takime në në Prefekturën e Beratit, Vlorës, Korçë, Kukës, Gjirokastrë, Fier, Dibër, Lezhë, Elbasan.
- ✓ Përmirësimi i borxhit i paraqitur në formë tabelare

Nr.	Vlera progresive e gjobës (lekë) 31.12.2024	Arkëtimet (lekë) Periudha Janar-Dhjetor 2024	Vlera e debisë shfuqizuar me Vendim Gjykatë/V.K.A (lekë)	Vlera e mbetur e debisë (lekë) Derimë 31.12.2024	Numri i debise progresive deri 31.12.2024
1.	106.436.442	14.848.000	4.200.000	87.388.442	303

ISHMT-ja gjithashtu ka përdorur një metodë “njoftimi nëpërmjet e-mailit” e cila ka siguruar efikasitet në ndërgjegjësimin e subjekteve pasi ka rezultuar se kanë reaguar me pagesa të detyrimeve të cilat i kanë patur të pashlyera. Kjo ka mundësuar një qasje të shpejtë dhe efikase për uljen e nivelit të borxhit dhe debisë së papaguar duke ruajtur një komunikim të vazhdueshëm me subjektet që kanë detyrime të papaguara.

Janë dërguar gjithsej 84 e-maile për “rikujtesë të pagesës së detyrimit” dhe 60 telefonata.

Më konkretisht kanë reaguar 5 (pesë) subjekte të cilët kanë kryer pagesën e detyrimit, në total 1.000.000 (një milion) lekë.


V. RAPORTIMET SIPAS DREJTORIVE (INSPEKTIMET)

Në total nga ISHMT gjatë vitit 2024 janë kryer 2983 inspektime nga të cilat 2796 inspektime të programuara dhe 187 jashtë programit mbi bazë ankese dhe nga aktivitetet monitoruese. Janë vendosur 109 masa administrative në total nga të cilat 5 paralajmërime, 101 gjoha dhe 3 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar 8684 produkte nga të cilat 118 kanë qënë jo në konformitet.

ISHMT ka realizuar 2983 inspektime në total nga të cilat Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve (DMP) ka realizuar 2233 inspektime dhe Drejtoria e Pronësisë Industriale (DPI) ka realizuar 750 inspektime (Tab.1). Referuar Planit vjetor të inspektimeve 2024 ISHMT ka realizuar 81% të totalit të inspektimeve të planifikuara në Planin e Inspektimeve për vitin 2024 (Tab.2).

Spektori Metrologjik ka realizim prej 81 %, Spektori i Produkteve Elektrike me 90 %, Spektori i Produkteve Mekanike me 80 %, Spektori Kimik me 72 % , Spektori i të Drejtave të Autorit me 54% dhe Spektori i Pronësisë Industriale 77% (Graf.1)

VI. Graf 1. Inspektimet e programuara dhe te paprogramuara sipas sektorëve



Mosrealizimi me 24% i inspektimeve të planifikuara lidhet edhe me angazhimin e ISHMT-së gjatë vitit 2024 për monitorimin dhe inspektimin e tregut në lidhje me ndalimin e qeseve plastike që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM nr.367, datë 20.5.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit, apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” të ndryshuar dhe më pas si pjesë e Task-Forcës në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 35, datë 19.02.2024 "Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Task- Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo



futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe të qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme”. Përgjatë vitit 2024, ka mbikëqyrur rreth **520** subjekte tregtare me NIPT, të cilët kishin në përdorim qese plastike mbajtëse. Nga ky aktivitet mbikëqyrës u konstatua se **4 (katër)** subjekte kishin në përdorim qese plastike mbajtëse jokonform legjislacionit në fuqi, ndaj të cilëve u morën **masa administrative (Gjobë)**, duke u sekuestruar rreth **380.3 kg** qese jokonform ligjit.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të qarqeve të ndryshme, ISHMT ka monitoruar rreth 648 subjekte ambulante.

ISHMT gjatë realizimit të detyrave funksionale ka kryer rreth 1336 inspektime, ku ka qënë pjesë e objektit të inspektimit edhe kontrolli i përdorimit/ofrimit gjatë veprimtarisë tregtare të qeseve plastike mbajtëse dhe qeset plastike të oxo-degradueshme dhe oxobiodegradueshme. Nga ky aktivitet inspektimi u konstatuan 5 (pesë) subjekte që kishin në përdorim qese plastike mbajtëse

jokonform legjislacionit në fuqi, ndaj të cilëve u morën masa administrative Gjorbë, duke u sekuestruar rreth 83.5 kg qese jokonform ligjit.

Gjatë kësaj periudhe, përveç sa më lart, ISHMT ka ndërmarrë edhe një fushatë informuese/ndërgjegjësuere duke realizuar rreth 3245 informime, në të cilat subjektet kanë konfirmuar marrjen e njoftimit lidhur me kërkesat ligjore që duhet të përmbushin qeset plastike që përdoren gjatë aktivitetit të tyre tregtar.

5.1 DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE (DMP)

Drejtorja e Mbiqëqyrjes së Tregut për produktet joushqimore gjatë vitit 2024 ka kryer në total **2283 inspektime** nga të cilat 2111 të programuara dhe 122 të pa programuara. Në raport me totalin është realizuar **87 %** e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2024. Janë vendosur **57 masa administrative në total** nga të cilat 52 janë gjoba, 2 paralajmërime dhe 3 masa urgjente. Janë kontrolluar **8684 produkte** nga të cilat 118 kanë qënë jo në konformitet. Në fokus për vitin 2024 ka qënë inspektimi i ashensorëve, lodrave, detergjentëve, instrumentave matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim, parapaketimet, produktet elektrike. Inspektimet kanë qënë të kombinuara duke përfshirë edhe kontrollin e zbatimit të Ligjit nr. 9902/2011 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, specifikisht për Nenet 7, 8, 9, 12, si dhe në zbatim të VKM për qeset plastike.

5.1.1 Inspektimi Metrologjik

Për vitin 2024, janë kryer **997 inspektime** nga të cilat **962** të programuara dhe **35** të pa programuar mbi bazë ankese/monitorim. Janë kontrolluar në total **3067 produkte**, nga të cilët **22 produkte** kanë qënë jo në konformitet. Janë vendosur në total **14 masa administrative** me vendim gjorbë.

Inspektime për parapaketim

Janë kryer **895 inspektime** të subjekteve që tregtojnë produkte të paketuara, të subjekteve prodhues dhe importues të parapaketimeve, si dhe gjatë këtyre inspektimeve në objektin e inspektimit është përfshirë edhe kontrolli i qeseve⁴ dhe kontrolli për zbatimin e LMK. Janë kontrolluar në total **1158 produkte**, nga të cilët 2 produkte kanë qënë jo në konformitet. Janë marrë 2 (dy) masa administrative gjorbë.

Inspektime për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, në përdorim

Janë kryer **64 inspektime** për instrumenta matës ligjërish të kontrolluara në përdorim. Janë kontrolluar **1774 instrumente matëse** nga të cilët **13 instrumente matëse** kanë qënë jo në konformitet. Janë marrë **5 (pesë)** masa administrative gjorbë.

⁴ VKM nr.367, datë 20.5.2022 “ Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit, apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”.

Inspektime për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që vendosen në treg

Janë kryer **28 inspektime** për instrumente matëse që vendosen për herë të parë në treg. Janë kontrolluar **125 instrumente matëse**. Nuk është vendosur asnjë masë administrative.

Inspektime mbi kontrollin e qeseve plastike

Janë kryer **10 inspektime** për kontrollin e qeseve plastike, në zbatim të VKM nr.367, datë 20.5.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit, apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”, të ndryshuar. Janë marrë **7 (shtatë)** masa administrative gjobë.

- Në kuadër të “PLANI I INFORMIMIT DHE KËSHILLIMIT TË SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT DHE KONSUMATORËVE QERSHOR – DHJETOR 2024” ISHMT ka ndërmarrë edhe një fushatë informuese/ndërgjegjësuere duke realizuar rreth **100 informime mbi furrat e bukës**, përkatësisht **95 subjekte në Tiranë** dhe **4 subjekte në Korçë**, në të cilat subjektet kanë konfirmuar marrjen e njoftimit lidhur me kërkesat ligjore që duhet të respektojnë subjektet që prodhojnë dhe/ose tregtojnë bukë, prodhime brumi etj.
- Për sa i përket qeseve plastike përkatësisht **në Tiranë** janë kryer **2608** informime, **në Durrës** janë kryer **222** informime, **në Elbasan** janë kryer **43** informime, **në Berat** janë kryer **17** informime, **në Lushnjë** janë kryer **25** informime, **në Fier** janë kryer **41** informime, **në Vlorë** janë kryer **42** informime, **në Gjirokastrë** janë kryer **69** informime, **në Pogradec** janë kryer **28** informime, **në Korçë** janë kryer **56** informime, **në Lezhë** janë kryer **31** informime, **në Shkodër** janë kryer **58** informime dhe **në Dibër** janë kryer **5** informime, pra **në total janë informuar 3245 subjekte.**

5.1.2. Produkte elektrike

Për vitin 2024 objekt të inspektimeve të këtij sektori kanë qenë produktet e përgjithshme elektrike dhe mbrojtja e konsumatorit dhe inspektimet për qeset plastike. Në total nga ky sektor janë kryer **484 inspektime**⁵, ku **420** kanë qenë të programuara dhe **64** inspektime të jashtë programit, të nxitura nga ankesat dhe aktivitetet monitoruese. Janë vendosur në total **9 masa administrative gjobë**. Janë kontrolluar **906 produkte** në total nga të cilat **9 kanë qënë jo në konformitet**.

Inspektimet për produktet elektrike

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” dhe vkm-e përkatëse (LVD, EMC, RED dhe etiketimi energjisë), janë inspektuar rreth **440 operatorë ekonomikë** importues dhe shpërndarës të

⁵ Në zbatim të Ligjit nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” dhe VKM-e përkatëse për LVD, EMC, RED dhe etiketimi energjisë.

produkteve elektrike, produkte që mbulohen nga një rregull teknik dhe produkte që nuk mbulohen nga një rregull teknik. Janë vendosur **9 masa administrative gjobë** (produkte jo në konformitet përse i përket deklaratës së konformitetit). Në maj të vitit 2024 është miratuar ligji i ri “Ligji nr.52/2024 LIGJ Nr. 52/2024 “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji” i cili do të plotësohet me aktet nënligjore brenda muajit maj të vitit 2025.

Inspektimet për mbrojtjen e konsumatorëve

Në zbatim të Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatoreve”, i ndryshuar dhe neneve 5, 7-12, 18, 30-33 dhe 52/1, sipas planeve mujore të inspektimit të miratuara të përfshira në objektin e inspektimit ka qenë edhe mbrojtja për konsumatorin, ku numri total i kontroleve përgjatë vitit 2024 është 447 subjekte. Referuar ankesave Sektori i Produktëve Elektrike gjatë këtij viti 2024 ka trajtuar **12 ankesa** dhe **4 kërkesa/informacion**, të ardhura në e-mail-in e kontaktit të ISHMT-së si dhe nepermjet protokollit. Nga këto ankesa ku nga të cilat kane qenë 4 blerje online dhe 8 ankesa direkte, janë zgjidhur 8 me marrëvshje dhe një me inspektim. Janë përmbushur kërkesat për informacion apo deleguar në institucione të tjera sipas rasteve dhe kërkesave të referuara.

5.1.3. Produkte mekanike

Për vitin 2024 janë kryer në total **280 inspektime**, nga të cilat **272** kanë qenë të programuara dhe **8** inspektime të paprogramuara, të nxitura nga ankesat dhe aktivitetet monitoruese. Janë vendosur **22 masa administrative** në total nga të cilat 1 paralajmërim, 18 gjoba dhe 3 masa urgjente (ndalimi i përdorimit të ashensorëve). Janë kontrolluar **673 produkte/instalime** në total nga të cilat **84 produkte/instalime kanë qënë jo në konformitet**.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar:

Inspektimet për ashensorët:


215 inspektime për sigurinë e ashensorëve dhe janë kontrolluar 486 produkte/instalime nga të cilat 72 produkte/instalime jo në konformitet. Janë vendosur në total **19 masa administrative** nga të cilat 15 gjoba, 1 paralajmërim dhe 3 masa urgjente (ndalimi i përdorimit të ashensorit).

Për vitin 2024 janë regjistruar pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut **720 ashensorë**.

Nr. i ashensorëve të regjistruar për vitin 2024							
Tipi i Godinës	Vende Pune		Ndërtesa në bashkëpronësi		Mjedise Shtëpiake		Total i
	Elektrik	Hidraulik	Elektrik	Hidraulik	Elektrik	Hidraulik	
Lloji Ashensorit							
Instalim para 2020	58	32	24	1	1	1	117

Instalim pas 2020	180	20	370	3	29	1	603
Totali	238	52	394	4	30	2	720

- ❖ Për sa i përket regjistrimit të ashensorëve ndër vite vihet re një shtim gradual (me përjashtim të vitit 2022) në numrin e regjistrimeve ku në vitin **2019** janë regjistruar 67 ashensorë, në vitin **2020** janë regjistruar 543 ashensorë, në vitin **2021** janë regjistrua 648 ashensorë, në vitin **2022** janë regjistruar 430 ashensorë dhe në vitin **2023** janë regjistruar 679 ashensorë.



Inspektimet për makineri:

31 inspektime për makineritë, të subjekteve që vendosin në treg makineri, ku janë kontrolluar 88 produkte, nga të cilat 9 produkte jo në konformitet. Janë vendosur **2 masa administrative (gjobë)**.

Inspektime për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP):

10 inspektime për PMP ku janë kontrolluar 41 produkte të cilat kanë rezultuar në konformitet. Nuk është marrë **asnjë masë administrative**.

Inspektime për enët e thjeshta në presion

1 inspektim për enët e thjeshta në presion ku janë kontrolluar 2 produkte të cilat kanë rezultuar në konformitet. Nuk është marrë **asnjë masë administrative**.

Inspektimet për pajisjet e gazit

23 inspektime për pajisjet e gazit, të subjekteve që vendosin në treg pajisje gazi, ku janë kontrolluar 56 produkte, nga të cilat 3 produkte jo në konformitet. Është vendosur **1 masë administrative** (gjobë).

Trajtimi i ankesave

Sektori i Produkteve Mekanike gjatë vitit 2024 ka trajtuar **19 ankesa**. 2 ankesa janë dorëzuar dorazi në protokollin e ISHMT-së, 17 ankesa kanë ardhur në e-mail-in zyrtar të ISHMT-së info@ishmt.gov.al.

5.1.4 Qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme

Për vitin 2024 në fokus të inspektimeve të këtij sektori kanë qenë lodrat, detergjentët, siguria e përgjithshme (artikujt për fëmijë: karroca, biberona, mbajtës biberona, takëmet e fëmijëve, etj), mbrojtja e konsumatorit, veshje këmbë dhe produktet tekstil. Në total nga ky sektor janë kryer **472 inspektime**, referuar planit të inspektimeve për vitin 2024 realizimi është 98%. Nga 472 inspektime në total **457** të programuara dhe **15** të paprogramuara të nxitura nga ankesat dhe aktivitetet monitoruese. Janë vendosur në total **12 masa administrative** nga të cilat 1 paralajmërim, 11 gjoba. Janë kontrolluar **4038 produkte në total** nga të cilat 3 nuk kanë plotësuar kriteret ligjore konform legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar:

Inspektimet për sigurinë e lodrave

Gjatë 2024 u kryen **43 inspektime** të operatorëve ekonomikë importues dhe shpërndarës të produkteve lodra⁶. Janë kontrolluar **279 produkte lodra** nga të cilat **3** kanë rezultuar jo në konformitet. Është vendosur **1(një) masë administrative gjobë**.

Inspektimet për detergjentët

113 inspektime në fushën e detergjentëve, të subjekteve tregtare prodhuese dhe importuese, të cilët janë kontrolluar në respektim të legjislacionit në fuqi Nr.10216/2010 “Për Detergjentët” dhe aktet nënligjore në fuqi për etiketimin. Janë kontrolluar **956 produkte detergjentë** për konsumatorë apo industrial të cilat kanë rezultuar konform kërkesave ligjore.

⁶ Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011“Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM Nr. 262/2013 Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e lodrave”.

Inspektime për veshjet e këmbës

47 inspektime për etiketimin e materialeve kryesore që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës bazuar në VKM nr.222, datë 28.03.2012 “Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët”. Janë kontrolluar 388 produkte të cilat kanë rezultuar konform kritereve për etiketimin sipas rregulloreve përkatëse.

Inspektime për përbërjen e fibrave të produkteve tekstile

114 inspektime për përbërjen e fibrave të produkteve tekstile bazuar në VKM nr.1058, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile”. Janë kontrolluar **878 produkte** të cilat kanë rezultuar konform kritereve për etiketimin sipas rregulloreve përkatëse.

Inspektimet për mbrojtjen e konsumatorëve

112 inspektime për mbrojtjen e konsumatorit në zbatim të neneve 7, 8, 9, 12 të Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, " Për mbrojtjen e konsumatoreve", i ndryshuar. Janë kontrolluar 1344 produkte.

Është kryer kontrolli për respektimin e neneve 7, 8, 9, 12 të Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, " Për mbrojtjen e konsumatoreve", i ndryshuar, në inspektimet me fokus lodrat, detergjentët, tekstilet, artikujt e fëmijëve dhe veshjet e këmbës në **218 subjekte**.

Janë vendosur në total **9 masa administrative gjoba**.

Inspektimet për sigurinë e përgjithshme

40 inspektime për sigurinë e përgjithshme në zbatim të Ligjit nr. 10480/2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore” i ndryshuar nga të cilat **2 kanë qenë të pa programuara** mbi bazë njoftimi ardhur nga MBZHR/sistemi RASF për produktet në kontakt me ushqimin. Janë kontrolluar gjithsej **181 produkte artikuj fëmijësh** përfshirë karrocet, rrethoret, biberonat dhe takëmet e fëmijëve në përputhje me standardet referuese që mbulojnë sigurinë e tyre, të cilat kanë rezultuar konform kritereve sipas standardeve përkatëse.

Monitorim, kontroll dhe inspektime për qeset plastike

Spektori Kimik dhe Siguria e Përgjithshme është angazhuar në monitorimin dhe inspektimin e tregut në lidhje me ndalimin e qeseve plastike që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM nr.367, datë 20.5.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit, apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”. Janë vendosur **2 masa administrative, gjobë** për mosrespektimin e kritereve ligjore për qeset plastike.

5.1.5. Trajnime

Gjatë vitit 2024 në fushën e mbikëqyrjes së tregut për produktet joushqimore janë kryer 5 trajnime për inspektorët si më poshtë:

1. Webinar “The GHS in the workplace”, lidhur me aplikimin e Sistemit Global të Harmonizuar (GHS) në vendin e punës në kuadër të forcimit të kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit dhe kritereve për **CLP-ne dhe GHS-se** në fushën e kimikateve, organizuar nga UNITAR;
2. Webinar online për PCBs (bifenilet e poliklorinuara), organizuar nga GGKP, 28 Tetor 2024;
3. Në kuadër të projektit “EU4 Business: Fostering the Common Regional Market Through Quality Infrastructure and E-Commerce”, u zhvilluan trajnimet me institucionet e infrastrukturës së cilësisë të vendeve të CEFTA-s për produktet elektrike - Produktet me rrezik dhe jo konform të tregut, Maqedoni;
4. Trajnim me temë “Strengthening Cooperation between Customs Administrations And Market Surveillance Authorities in Cefta”, Mali i Zi;
5. GIZ ORF FT Regional training “Procedures of Market Surveillance under the Construction Products Regulation (CPR)”, Shqipëri;

5.2 DREJTORIA E PRONËSISË INTELEKTUALE

Gjatë vitit 2024 nga Drejtoria e Pronësisë Intelektuale janë kryer në total **750 inspektime** nga të cilat **685** kanë qenë inspektime të programuara dhe **65** inspektime të pa programuara, mbi bazë ankese. Janë vendosur **52 masa administrative** nga të cilat 3 masa janë paralajmërim dhe 49 janë masa administrative me gjobë.

5.2.1 Inspektimi mbi të drejtën e autorit

Nga **633** inspektime të planifikuara në planin vjetor, në total janë kryer 343. Janë realizuar **340** inspektime të planifikuara dhe **3** të nxitura nga ankesat. Janë vendosur **40 masa administrative** nga të cilat 3 masa janë paralajmërim dhe 37 janë masa administrative me gjobë.

Inspektimi i programeve kompjuterike

Janë kryer **305 inspektime** mbi subjektet përdorues të programeve kompjuterike. Janë marrë **39** masa administrative gjobë.

Inspektimi i Shtëpive Botuese/librari/fotokopje

Janë kryer **38 inspektime** mbi kategoritë e përdoruesve të veprave letrare. Është marrë **1** masë administrative gjobë.

5.2.2 Inspektive mbi pronësinë industriale

Gjatë vitit 2024 janë kryer në total **407 inspektive**, nga të cilat **345** inspektive janë realizuar ex-officio dhe **62** inspektive janë kryer të nxitura nga ankesat e mbajtësit të së drejtës dhe aktivitetet monitoruese. Janë vendosur në total **12 masa administrative** me gjobë.

Janë trajtuar **41 kërkesë ankesa** për inspektim.

Eshtë vendosur bllokim i përkohshëm për gjithsej **532** detergjentë të markave “Ariel” dhe “Fairy” mallra të dyshuara si të falsifikuara dhe **7** veshje të dyshuara si falsifikime të markave "Givenchy", "Off White", "Armani Exchange", "Calvin Klein", "The North Face”.

Është vendosur bllokim i përhershëm dhe vendim për shkatërrim për gjithsej **23** veshje të konfirmuara si të falsifikuara me markat “Moncler” dhe “Stone Island”, si dhe për **29** copë detergjent pluhur me markën “Ariel”.

5.2.3. Trajnime

Gjatë vitit 2024 në fushën e **pronësisë intelektuale** janë kryer 6 trajnime për inspektorët si më poshtë:

1. Dt. 06.03.2024 ISHMT mori pjesë në Trajnim online në lidhje me PIEA, organizuar nga zyra e Kryenegociatorit mbi përdorimin platformës online për Kapitullin 7.
2. 11.03.2024 Stafi i Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale të ISHMT mori pjesë në Ëorkshop "Building respect for intellectual property rights ëith judiciary system and laë enforcement authorities" organizuar nga DPPI me support të projektit ALSIP. Temat e diskutuara në këtë trajnim kishin të bënin me zbatimin e të drejtës së pronësisë intelektuale në Shqipëri, kriminalizimi i Pronësisë Intelektuale në këndvështrimin e TRIPS dhe legjislacionit shqiptar, gjithashtu u diskutuan dhe raste konkrete të trajtuara nga gjykatat në Shqipëri, si dhe nga gjykatat ndërkombëtare. Zhvilluar në Hotel International Tirana.
3. Dt 15.04.2024, Workshop prezantues mbi metodologjinë për kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të kapaciteteve dhe strukturave të integritit evropian në zbatim të përgjegjësiave dhe detyrave të tyre të përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për kapitullin 7. Organizuar nga projekti SANECA II, zbatuar nga GIZ në Shqipëri, si dhe projekti i Bashkimit Evropian ‘Support for EU Integration, SEI’. Qëllimi i projektit është evidentimi dhe vlerësimi i nevojave të institucioneve të GNPIE-ve në lidhje me kapacitetet njerëzore për të përmbushur përgjegjësi të tyre të përcaktuara në kuadër të procesit të integritit në BE, si shtim i stafit ose trajnim i stafit të angazhuar në GNPIE.
4. Dt. 26.04.2024 Trajnim i inspektorëve të ISHMT mbi identifikimin e mallrave të falsifikuara të Kompanisë “The Procter & Gamble” për të dalluar kodet shenjat dhe informacionet te cilat mundësojnë identifikimin e mallrave te falsifikuara nën markat, Ariel, Lenor, Fairy, Head & Shoulders. Zhvilluar në ambjentet e ISHMT.
5. Dt. 18-19 Qershor Trajnim dy ditor me temë " Trajnimin mbi procesin e përafrimit të Acquis së BE-së në Shqipëri - konfirmimi 10 Qershor 2024", ku u prezantuan njohuri mbi procesin e integritit, plotësimin e tabelave të perpuethshmërisë për anëtarët e GNPIE-ve.

6. Dt. 01.11.2024 Trajnim i stafit të ISHMT në Inspektoratin Qendror mbi përdorimin e sistemit e-inspektimi.

5.3. DREJTORIA TEKNIKE (DT)

Përshkrim i shkurtër

Drejtoria Teknike ka një strukturë të miratuar të stafit me 7 punonjës (1+6). Numri i punonjësve të DT në fund të vitit 2024 ishte 7.

Fusha e veprimtarisë së kësaj drejtorie është:

- ✓ Kontribuimi në përgatitjen dhe zhvillimin e politikave të mbikëqyrjes së tregut;
- ✓ Ndjekja e përditësimit me direktivat përkatëse të BE-së/rregulloreve të transpozura për mbikëqyrjen e tregut;
- ✓ Koordinimi i mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të informacioneve mbledhur nga dy drejtoritë e tjera;
- ✓ Analiza e raporteve periodike të dorëzuar nga çdo sektor në lidhje me punën e kryer në terren (inspektime), problematikën e hasur dhe sugjerimet për përmirësimin në vazhdimësi;
- ✓ Përpunimi i statistikave të mbledhura mbi inspektimet e kryera gjatë kësaj periudhe kalendarike në raport me Indikatorët e Performancës;
- ✓ Zhvillimi, koordinimi dhe bashkërendimi i politikave në fushat që mbulon ISHMT, si dhe kur është e nevojshme, bashkëpunon me drejtori të tjera të ISHMT-së dhe me institucione të tjera shtetërore, private, aktorë ndërkombëtarë;
- ✓ Raportimi i brendshëm e i jashtëm i ISHMT-së.

5.3.1 Raporte të hartuara

Kjo drejtori ka gjeneruar raporte periodike të brendshme dhe për institucione e organizma të tjera sipas kërkesave të vazhdueshme drejtuar ISHMT-së. Raportet e hartuara nga kjo drejtori janë:

- ✓ Raportimet periodike të ISHMT-së (javore, mujore, 6-mujore dhe vjetore);
- ✓ Raporte monitoruese mbi punën e kryer nga ISHMT. Përgatitje informacionesh për CEFTA(Pyetësori për mbikëqyrjen e tregut), raportime periodike për kapitullin 1 dhe 28 , etj.
- ✓ Raporte mbi produktet e rrezikshme të publikuara në safety gate , në formën e një buletini informative, i cili publikohet çdo javë dhe i dërgohet Administratës Doganore çdo 2 javë.
- ✓ Raportin për Inspektoratin Qendror (IQ) mbi inspektimet e realizuara në bazë të një liste indikatorësh të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm.
- ✓ Raporte monitoruese mbi punën e kryer nga ISHMT.
- ✓ Përgatitje informacionesh për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Sipërmarrjes, CEFTA, SME, etj.

5.3.2 Aktivitetet

1. Gjatë vitit 2024, Drejtoria Teknike ka kontribuar në forcimin e marrëdhënieve të ISHMT me vendet e rajonit dhe ka marrë pjesë në aktivitete me partnerët ndërkombëtarë në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
2. DT ka qënë pjesëmarrëse në aktivitete të zhvilluara nga CEFTA në kuadër të projektit SEED+ për sistemin e shkëmbimit të informacionit për produktet jo të sigurta dhe projektit për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet administratave doganore dhe autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut në vendet e CEFTA-s .
3. Në datën 23 Tetor 2024, u zhvillua nënkomiteti për kapitullin 1 , ku përfaqësues nga drejtoria teknike raportuan përpara komisionit evropian lidhur me aktivitetin e ISHMT dhe arritjet për vitin 2024. Kjo drejtori ka dhënë mbështetje për raportimin e ISHMT edhe në kapitujt 28, 12, 14, 15, 27.

Trajnime

1. **26 qershor 2024, ora 09:00, në Tirana International Hotel - Konferenca e VI Kombëtare** “E Drejta për Informim - Ndërtimi i besimit - Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit”.
2. **16 Korrik 2024, ora 09:00**, pranë ambienteve të IQ - Trajnimi i rolit jurist për sistemin “e-Inspektimi”
3. **1 Nëntor 2024 , ora 09:00** , pranë ambienteve të IQ, - Trajnimi i detyrueshëm për të gjithë trupën inspektuese të ISHMT-së lidhur me ndryshimet e aplikacionit të ri.
4. **20 dhjetor 2024 ora 09:30 (online)** - E Drejta për Informim – Të dhënat e hapura- Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve”

5.3.3 Mbështetje për plotësimin , përmirësimin dhe përditësimin e legjislacionit sektorial të fushë veprimtarisë së ISHMT-së

1. Dhënie e asistencës teknike/juridike për sektorët DMP në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fushën e përgjegjësive të ISHMT.
2. Drejtoria Teknike ka evidentuar problematikat që lidhen me zbatueshmërinë e VKM 925, date 25.11.2020 “ Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet e aerosolit” dhe draft-VKM për pajisjet e gazit.
3. Ka dhënë komente lidhur me aktet ligjore të ardhura për mendim:
 - a. Projektligjin “Per etiketimin e produkteve me ndikim ne energji”;
 - b. Projektligjit “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

4. Përgatitja e databazës ligjore, me komentet përkatëse të çdo sektori, me qëllim që problematikat e evidentuara për aktet ligjore/nënligjore, të adresohen për ndryshim/përmirësim në ministrinë e linjës.
5. Merr pjesë në aktivitetet dhe nismat që zhvillohen në kuadër të marrëveshjes së tregtisë së lirë CEFTA.

5.3.4 Mbështetje në zbatimin dhe hartimin e metodologjive të lidhura me procesin e inspektimit

Drejtoria Teknike ka mbështetur punën për hartimin e listë-verifikimeve dhe dokumentave standarde për produkte që përfshihen në fokusin e punës së DMP.

- DT ka kontribuar në hartimin e :
 - ✓ Draft-Rregullores së brendshme të ISHMT-së;
 - ✓ Rregullores së re të komisionit të ankimit;
 - ✓ Planit të Informimit dhe Këshillimit të subjekteve të inspektimit dhe konsumatorëve qershor-dhjetor 2024”, i mbështetur në “Strategjinë Ndërsektoriale Për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut” 2024 – 2030.;
 - ✓ Listë verifikimeve për pajisjet e gazit dhe enëve të thjeshta nën presion;
 - ✓ 2 marrëveshjeve të bashkëpunimit, përkatësisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit.
 - ✓ Urdhërit “Për unifikimin e praktikave të mbikëqyrjes së tregut dhe inspektimit”, i cili unifikon afatet për strukturat inspektuese të ISHMT në respektim të plotë të kuadrit ligjor dhe synon menaxhimin sa më korrekt të procedurës administrative të inspektimit. Urdhëri hyri në fuqi më datë 1 dhjetor 2024.
- DT ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me IQ në lidhje me zbatimin e sistemit të inspektimit online, E-inspection, mbi problematikat e ndeshura, eliminimin e tyre, etj.
- DT ka mbledhur të dhëna statistikore nga çdo sektor/drejtori në lidhje me inspektimet të cilat hidhen rregullisht në një database, përpunohen dhe prezantohen në raporte të ndryshme si dhe shërbejnë si bazë për monitorimin e punës së ISHMT-së duke evidentuar problematikat dhe përcaktuar mënyrat për minimizimin/ose eliminimin e tyre.
- DT ka publikuar rregullisht informacione mbi veprimtarinë kontrolluese të ISHMT, me të dhëna të dobishme për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë.

5.4. DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka 2 sektorë, Sektori Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse 1+7 (aktualisht 7 punonjës) dhe Sektori Financës 1+2 (aktualisht 3 punonjës).

5.4.1 Ndjekja e masave administrative deri në ekzekutimin e tyre

- Për 82 masa administrative, janë dërguar Kërkesat për Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
- Për 16 masa administrative, janë dërguar Kërkesat për Vërtetim nëse subjektet kanë depozituar Kërkesë-Padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
- Për 8 masa administrative, Sektori Juridik është në pritje të plotësimit të afatave ligjore (30 ditë për ankimin administrativ/ 45 ditë për depozitimin e Kërkesë-Padisë në Gjykatën kompetente)
- Për 3 masa administrative të cilat i përkasin vitit 2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka refuzuar kërkesën për lëshimin e urdhrit dhe është bërë ankimi i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit.

5.4.2 Ndjekja e ankimeve administrative të gjobave të vendosura nga strukturat e ISHMT

Përgjatë periudhës Janar 2024- Dhejtor 2024, Sektori Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse pas verifikimit të kryer në sistemin E-inspektimi, rezulton se janë vendosur gjithsej **106 masa administrative gjobë**.

Pranë ISHMT-së janë paraqitur 45 ankime administrative, nga të cilat:

- 42 masa administrative janë lënë në fuqi me Vendim të Komisionit të Ankimit (KA)
- 1 masë administrative është shfuqizuar me Vendim të Komisionit të Ankimit (KA)
- 2 masa administrative janë ndryshuar me Vendim të Komisionit të Ankimit (KA)
- 52 masa administrative rezulton të jenë të paankimuara administrativisht.
- 9 masa administrative të vendosura ne 2024 kanë qënë pjesë e Komisionit të Ankimit 2025.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2024, janë zhvilluar gjithësej 17 mbledhje Komisioni Ankimi. Në respektim të procedurave të parashikuara në Urdhrin nr. 84, datë 23.05.2024 “*Për miratimin e procedurave të hollësishme të shqyrtimit të ankimit administrativ nga Komisioni i Ankimit pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut*”, janë ndjekur të gjitha procedurat e njoftimit të subjekteve për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të Komisioneve të Ankimit.

Vendimet e Komisionit të ankimit janë arsyetuar plotësisht duke pasur për pasojë uljen e numrit të Vendimeve të cilat janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë kompetente.

Në shenjë sqarimi, evidentohet se deri më tani, nga 48 subjekte të cilat kanë ankimuar Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, vetëm 11 prej tyre kanë paraqitur kërkesë padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë kompetente, nga të cilat për 1 (një) është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë, kurse 10 (dhjetë) të tjera vijnë në proces gjyqësor.

5.4.3 Përfaqësimi i ISHMT-së në procese gjyqësore

Gjatë vitit 2024 janë ndjekur në Gjykatë gjithësej 18 procese gjyqësore, nga të cilat:

- 1 kërkesëpadi është rrëzuar e subjektit ankimues;
- 1 kërkesëpadi është pranuar kundër ISHMT-së;
- 16 çështje janë në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë/Lushnjë;

5.4.4 Buxheti & Financa

Për sa i përket **buxhetit të miratuar për ISHMT** për vitin 2024 nga fondi i rishikuar prej 153.976 mijë lekë janë shpenzuar 142.492 mijë lekë, pra 93 % e buxhetit total është përdorur, sipas tabelës si mëposhtë:

Tabela 3: Buxheti i alokuar dhe shpenzuar për vitin 2024

(/000 lekë)

Zërat	Emërtimi	Buxheti ne fillim vitit	Shtim fondi gjate vitit 2024	Pakësim fondi gjate vitit 2024	Buxheti i rishikuar	Fondet e shpenzuara	Realizimi (%)
600	Paga	93.400	16.953	9.000	101.353	100.500	99%
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	18.900	0	2.000	16.900	16.685	99%
602	Shpenzime korente	18.308	7.000	0	25.308	24.029	95%
606	Fond i veçantë	348	275	208	415	385	93%
231	Investime	10.000	0	0	10.000	893	9%
Totali		140.956	24.228	11.208	153.976	142.492	93%

Për pagat e punonjësve të ISHMT janë paguar 100.500 mijë lekë ose 99 % e totalit të buxhetit të rishikuar gjatë vitit buxhetor 2024 në shumën 101.353 mijë lekë.

Për Sigurimet Shoqërore Shëndetësore dhe Tatimet për pagat e marra nga punonjësit e ISHMT janë paguar 16.685 mijë lekë ose 99 % e totalit të të buxhetit të rishikuar gjatë vitit 2024 në shumën 16.900 mijë lekë.

Për shpenzimet korrente janë paguar 24.029 mijë lekë ose 95 % e fondit të rishikuar të buxhetit në shumën 25.308 mijë lekë.

Për zërin e Investimeve janë përdorur 893 mijë lekë ose 9 % e totalit të buxhetit të rishikuar për vitin 2024 në shumën 10.000 mijë lekë.

Nga planifikimi i zërit të investimeve për vitin 2024 është realizuar projekti me kod M100538 në vlerën 892.560 lekë.(AKSHI).

Nuk është realizuar Projekti me kod 24AG201 “Blerje automjete” (O.B.P).

5.4.5 Ndjekja e arkëtimeve të masave administrative të vendosura nga strukturat e ISHMT

Përgjatë vitit 2024, janë arkëtuar shuma për 66 masa administrative, nga të cilat:

- 14 masa administrative janë të vendosura në vitin 2024
- 52 masa administrative janë të vendosura në vitet paraardhëse.

Për vitin 2024, janë 22 masa administrative (të vendosura edhe në vitet paraardhëse, por për shkak të zgjatjes së procesit gjyqësor, është marrë vendimi nga Gjykata në vitin 2024) të shfuqizuara me vendim gjykatë.

Për vitin 2024 janë arkëtuar nga gjobat të ardhura në buxhet **14.848.000** lekë.

5.4.6 Burimet njerëzore

ISHMT ka në organikë 80 punonjës, nga të cilët 77 janë të emëruar dhe 3 pozicione janë aktualisht vakante. Numri i punonjësve sipas sektorëve dhe drejtorive përkatëse është si në tabelën më poshtë.

Tabela 4: Staf i ISHMT sipas sektorëve dhe drejtorive, Dhjetor 2024

Drejtoritë/Sektorët	Numri i punonjësve sipas strukturës së miratuar	Numri aktual i punonjësve	%
DREJTORIA TEKNIKE	7	7	100%
DREJTORIA E MBIKEQYRJES SE PRODUKTEVE	42	40	95%
Sektor i Produkteve Elektrike	7	7	100%

Spektori i Produkteve Mekanike	9	9	100%
Spektori i Metrologjisë	16	15	94%
Spektori Kimik dhe Siguria e Përgjithshme	9	9	100%
DREJTORIA E PRONËSISE INTELEKTUALE	18	18	100%
Spektori i Pronësisë Industriale	7	7	100%
Spektori i të Drejtave të Autorit	10	10	100%
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	12	11	92%
Spektori Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse	8	7	88%
Spektori i Financës	3	3	100%
	80	76	95%

Disiplina në punë

Gjatë vitit 2024 është verifikuar listëprezenca e nëpunësve dhe sistemi i hyrje-daljeve në ISHMT. Është monitoruar zbatimi i Kodit të Etikës së ISHMT-së. Janë kryer vlerësimet e punës për periudhat korrik-dhjetor 2023 dhe janar-qershor 2024.

Performanca sipas kriterëve

ISHMT funksionon sipas strukturës së miratuar me Urdhërin nr. 73, datë 01.06.2020 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, i ndryshuar, e përbërë nga 4 njësi organizative (Drejtori), 8 njësi organizative (Sektorë) dhe gjithësej 80 punonjës (Tab.4). Ky institucion e ushtron veprimtarinë e tij sipas Rregullores së Brendshme të miratuar me urdhër të Ministrit Përgjegjës.

Masa disiplinore të marra

Në vitin 2024 nuk është ngritur asnjë komision disiplinor dhe është ndërmarrë asnjë masë vërejtje.

Ngritje në detyrë, lëvizje paralele

Gjatë vitit 2024 janë kryer: 8 (tetë) pranime nga jashtë shërbimit civil; 1 (një) lëvizje paralele; 2 (dy) emërimet me kontratë brenda strukturës, 10 emërimet punonjës me kontratë të përkohshme jashtë strukturës. Gjithashtu në muajin nëntor 2024 është bërë kërkesa për miratimin e numrit të shtuar të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2025.

Trajnime

Gjatë vitit 2024 stafi i kësaj drejtorie ka marrë pjesë në 12 trajnime të organizuar nga ASPA, trajnim në lidhje me hartimin e legjislacionit, procedurat administrative, prokurimin publik, burimet njerëzore, buxhetin afatmesëm, të drejtën e informimit, metodologjia e vlerësimit të rriskut, AMFIS, etj.

VI. PUBLIKIME & AKTIVITETE SENSIBILIZUESE

6.1 Publikime

Me mbështetjen e GIZ dhe të projektit ALSIP të zyrës Zviceriane të Pronësisë Intelektuale janë printuar broshura informuese mbi parapaketimet, LVD, shishet enëmatëse, të drejtat e pronësisë intelektuale, etj.

Është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme **informacioni në web-site** e ISHMT-së www.ishmt.gov.al.

Përditësimi i rrjeteve sociale mbi aktivitetet mbikëqyrëse të kryera nga ISHMT në bazë javore, si dhe publikimi i informacioneve të dobishme për konsumatorët apo operatorët ekonomikë.

6.2 Aktivitete sensibilizuese

Në total nga ISHMT gjatë vitit 2024 janë realizuar 10 aktivitete/fushata informimi për informimin e operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve, printim dhe shpërndarje e fletëpalosjeve informuese në lidhje me fushë veprimtarinë e ISHMT-së.

- Për ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe të operatorëve ekonomikë **për sigurinë e produkteve joushqimore** janë realizuar aktivitetet si më poshtë:
 - Pjesëmarrje në panel diskutimi "Piruni Digjital" me synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe besimit të konsumatorëve në blerjet ushqimore në internet në kuadër të Ditës Botërore të Konsumatorit, organizuar nga Bashkia e Tiranës, datë 20 Mars 2024, Salla e Kongresit Rinor Kombëtar, Tiranë.
 - Në 1 Qershor - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) në bashkëpunim edhe me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes së Konsumatorit në Bashkinë e Tiranës, organizoi në Pedonalen e qytetit të Tiranës një aktivitet sensibilizues dhe informues të prindërve mbi rëndësinë e përzgjedhjes së lodrave dhe produkteve për kujdesin e fëmijëve të tyre. Në këtë aktivitet u shpërndanë materiale informuese si fletëpalosje, broshura dhe postera, mbi sigurinë e lodrave, mbi paralajmërimet që duhet të shoqërojnë artikujt e kujdesit për fëmijë si: rrethore të

lëvizshme dhe të palëvizshme, takëmet e ngrënies të fëmijëve, biberonat, mbajtësit e tyre si dhe instruksionet e përdorimit dhe të mirëmbajtjes, të cilat duhet të kontrollohen dhe lexohen me vëmendje për të shmangur rreziqet që ato mund paraqesin për jetën e fëmijëve.

- Përgatitja e materialeve informuese për rrjetet sociale për informimin e konsumatorëve, në lidhje me sigurinë e lodrave, sigurinë e artikujve të kujdesit për fëmijë, imitimet e rrezikshme, mbi etiketimin dhe treguesin e çmimit referuar Ligjit nr.9902/2008 “për mbrojtjen e konsumatorit”, mbi etiketimin e veshjeve të këmbës, etj.
- Në zbatim të “*PLANI I INFORMIMIT DHE KËSHILLIMIT TË SUBJEKTEVE TË INSPEKTIMIT DHE KONSUMATORËVE QERSHOR – DHJETOR 2024*”, i mbështetur në “Strategjinë Ndërsektoriale Për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut” 2024 – 2030, janë organizuar fushata informuese/ndërgjegjësuëse (përgjatë periudhës Qershor-Dhjetor 2024) për **qeset plastike mbajtëse që përdoren gjatë aktivitetit tregtar dhe tregtimin e bukës dhe prodhimeve të brumit**. Në funksion të kësaj fushate janë hartuar edhe formate njoftimi/këshillimi për subjektet, në mënyrë që të njihen me kërkesat ligjore që duhet të përmbushin gjatë tregtimit.

➤ Për ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë **për të drejtat e pronësisë intelektuale** janë realizuar aktivitet si më poshtë:

- Dt. 20.03.2024, Aktivitet ndërgjegjësuë, Leksion i hapur në Universitetin Politeknik të Tiranës me tematike "Rendësia e Disenjës Industriale" ISHMT, DPPI, DDA, zhvilluar në ambjentet e UPT. Nga ISHMT Studenteve iu shpjegua roli dhe funksioni I ISHMT për zbatimin e të Drejtave të PI, procedurat, veprimet që përbëjnë shkelje të të drejtave, si dhe te drejtat dhe detyrimet e pronareve të objekteve te PI.
- Dt. 29.04.2024, Aktivitet ndërgjegjësuë, Leksion i hapur në Universitetin e Tiranës me tematike "Pronësia Intelektuale Përafrimi i Legjislacionit me Aquis e BE" zhvilluar nga DPPI, DDA dhe ISHMT. Studenteve iu shpjegua roli dhe funksioni i ISHMT për zbatimin e të Drejtave të PI, procedurat, veprimet që përbëjnë shkelje të të drejtave dhe te drejtat dhe detyrimet e pronareve të objekteve te PI, si dhe përafrimin me Direktivën e BE 2004/48 “Për zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale”.
- Dt. 20.06.2024 ISHMT ishte pjesë në panelin II të konferencës “Pronësia intelektuale dhe inovacioni -Shqipëria dhe rruga drejt Bashkimit Evropian” zhvilluar në mjediset e Hotel Tirana International me temë: “Pronësia Intelektuale dhe Inovacioni -Shqipëria dhe rruga drejt Bashkimit Evropian” në bashkëpunim të ngushtë me ICC Albania, Dhoma Amerikane e Tregtisë, dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Francë - Shqipëri si dhe me mbështetjen e projektit shqiptaro-zvicerian në fushën e Pronësisë Intelektuale ALSIP si dhe projektit Saneca II/GIZ Albania. ISHMT prezantoi rolin institucional në sistemin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, duke konkretizuar mbrojtjen e punës intelektuale të krijuesve, sipërmarrësve dhe inovatorëve në treg.

- Dt. 04.10.2024 ISHMT ishte pjesë në Workshopin IP4STARTUP të zhvilluar në Qendra PROTIK me suportin e projektit ALSIP, ISHMT prezantoi rolin dhe funksionet e ISHMT për zbatimin e të drejtave të PI në treg, me fokus programet kompjuterike.
- Dt. 25.10.2024 ISHMT mori pjesë në takimin me grupet e interesit për të drejtat e Autorit të organizuar me suportin e projektit ALSIP nga DDA. ISHMT prezantoi rolin dhe funksionet e ISHMT për zbatimin e të drejtave të PI në treg, për respektimin e të drejtave të autorit.
- Publikime në website dhe rrjetet sociale të ISHMT-së me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për respektimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale, kryesisht në muajin Prill në kuadër të 26 Prill “Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale”.

Vendosja e komunikimit ndër institucional dhe me palët e interesit

- Dt. 26.01.2024 ISHMT mori pjesë në Takim ndërinstitutional “Lançimi i strategjisë së Qendrës së Trajnimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale për një periudhë 5 vjeçare 2023-2028”. Me pjesëmarrjen e institucioneve të përfshira në sistemin e PI si DPPI, ISHMT, DDA, DPD, MA, Përfaqësues të autorizuar, Universitete , zhvilluar në Hotel International Tirana.
- Dt. 29.02.2024, ISHMT mori pjesë online në Steering committee i 7-të I projektit ALSIP. "Në këtë komitet u prezantuan aktivitetet e kryera në 6 mujorin e dytë të vitit 2023, në suport të institucioneve DPPI, DDA, ISHMT, Ministria e Bujqësisë (për treguesit gjeografikë) dhe Plani aktiviteteve për të ardhmen i projektit.
- Dt. 12.03.2024, Takim ISHMT me përfaqësues të Zyrës Zviceriane të Pronësisë Intelektuale në kuadër të Projektit ALSIP ku u diskutua mbi ecurinë e projektit me ISHMT, nevojat për suport gjatë vitit 2024, rritja e kapaciteteve institucionale dhe aktivitete ndërgjegjësuere. Zhvilluar në ambjentet e ISHMT.
- Dt. 13.03.2024, ISHMT mori pjesë në takimin e GNPIE kapitulli 7, ku u diskutua mbi nevojën për vendimmarrje në lidhje me ligjin 9947/2008 “Për pronësinë industriale”, në lidhje me dispozitat që parashikojnë procedurat e ISHMT për zbatimin e pronësisë industriale, mbi zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere të përbashkëta DPPI, DDA dhe ISHMT. Zhvilluar në ambjentet e QKB.
- Dt. 31.05.2024, ISHMT mori pjesë në takimin e 15-të të Nënkomitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, Përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit” BE- Shqipëri “. ISHMT prezantoi sistemin e zbatimit të të drejtave të PI në Shqipëri, përfrimin e legjislacionit dhe institucionet zbatuese duke u siguruar mbajtësve të të drejtave të gjithë mekanizmin e duhur për garantimin e të drejtave të PI në Shqipëri, si dhe iu dha përgjigje pyetjeve të drejtuara nga Përfaqësuesit e palës së KE mbi raportimin në këtë Nënkomitet. Zhvilluar në KE, Bruksel, Belgjikë.
- Dt. 12.06.2024 dhe dt. 20.12.2024 ISHMT mori pjesë në mbledhjen e radhës së "Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025", Ku u diskutua mbi zbatimin

e planit të aktiviteteve të parashikuara në strategji dhe objektivat e ardhshme. Zhvilluar në ambientet e MEKI.

VII. PROBLEMATIKA TË HASURA

Mungesa në logjistikë

Si një problematikë kryesore evidentohet mungesa e logjistikës për inspektime në terren dhe mbarëvajtjen e punës në ISHMT, e cila përfshin mungesën e automjeteve, të ambienteve për magazinimin e produkteve të bllokuara, etj. Konkretisht mungesat e mjeteve të transportit për trupat inspektuese në kryerjen e detyrave funksionale të institucionit, sjellin vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve, duke pasur në konsideratë shtrirjen e gjerë territoriale (i gjithë territori i vendit) të ushtrimit të funksionit të ISHMT-së. Automjetet në pronësi të ISHMT-së të cilat janë në dispozicion të trupave inspektuese janë marrë me kalim kapitali nga DPM dhe MFE(MEKI), të cilat janë të amortizuara dhe kanë shfaqur probleme gjatë kryerjes së punës.

Nevoja për ristrukturim të institucionit

Ristrukturimi dhe shtimi i stafit diktohet nga disa faktorë:

- Harmonizimit të legjislacionit aktual me direktivat dhe rregulloret e BE në fushën e mbikëqyrjes së produkteve dhe në fushën e pronësisë intelektuale ka çuar në rritjen e gamës së produkteve /pajisjeve/instalimeve që janë pjesë e fushë veprimtarisë së ISHMT-së (qeset plastike mbajtëse, aeroplanët pa pilot, emetimi i CO2, kimikatet, pajisjet e gazit, pajisjet aerosol, takëmet në kontakt me ujqimin, etj). ISHMT është institucion raportues për Kapitullin 1, 28 dhe 7 si dh për nën/kapituj të Kapitujve 12, 14, 24, 27. Në fushën e Pronësisë intelektuale Ligji për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, parashikon 12 fusha të të drejtave të autorit që gëzojnë mbrojtje, por aktualisht inspektohen vetëm 4 fusha. Rritja e gamës së fushave të inspektimit, shton nevojën për shtimin e stafit.
- Shtrirja e gjërë territoriale të ushtrimit të veprimtarisë së ISHMT-së e cila funksionon si Drejtori Qendrore dhe jo me Zyra Rajonale;
- Institucion përgjegjës për zbatimin e Neneve 5, 7,8,9,11,12,18,31,32,33,52/pika 5 të Ligjit nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.
- Shtimi i fluksit shumë të lartë të praktikave administrative që shtron nevojën për rritjen e numrit të juristëve në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

Nevoja për përmirësime të legjislacionit në fushën e Mbikëqyrjes së Tregut dhe të Pronësisë Intelektuale

Për ashensorët

- Në zbatim të Ligji 10489 , datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, i cili është ligj horizontal nuk parashikon detyrime ligjore për instaluesit dhe mirëmbajtësit e ashensorëve në instalim, të cilët janë hallka kryesore, për sa i përket instalimit dhe përdorimit të ashensorëve. Mungesa e këtyre parashikimeve krijon një boshllëk ligjor dhe pamundësi për zbatimin e akteve ligjore përkatëse, gjithashtu referuar problematikave të hasura në zbatimin e legjislacionit të sipërpërmendur është i domosdoshëm ndryshimi i legjislacionit në fuqi për ashensorët dhe parashikimi i masave administrative për instaluesit dhe mirëmbajtësit e ashensorëve.
- Në zbatim të Ligji 10489 , datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar VKM-së dhe 1056 “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, është evidentuar problematika në lidhje me personin përgjegjës (administratorin e pallatit) për ndërtesat në bashkëpronësi, pasi në një pjesë të madhe të ndërtesave nuk ka administrator pallati, gjë që e bën të pamundur realizimin e një inspektimi në përputhje me procedurën e miratur sipas legjislacionit në fuqi, pasi në çdo rast kërkohet një person përgjegjës (administrator) për instalimin.
- Në zbatim të Ligji 10489 , datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar VKM-së dhe 1056 “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, problematikë është mungesa e një procedure për ndalimin e përdorimit të instalimit (ashensorit).
- Në kuadër të procesit të derregullimit mbi lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët, Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut ka identifikuar nevojën për ndërhyrje në disa akte nënligjore me efekt lehtësimin e procedurave për subjektet, konkretisht në shërbimin për pajisjen me certifikatë për regjistrimin e ashensorit, pika 4.1 e VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, i ndryshuar.

Për detergjentët

- Kërkohet mbështetje me ekspertizë ligjore për finalizimin e draft ligjit për detergjentët (ndryshimin e Ligjit nr. 10 216, datë 21.1.2010 “Për detergjentët”).

Rishikimi i kuadrit ligjor për blerjet online

Rëndësia e përputhshmërisë, sigurisë së produktit dhe mbrojtjes së konsumatorit po rritet me rritjen e tregtisë elektronike dhe zgjerimin e gamës së produkteve të konsumit që mund të blihen online. Dyqane elektronike dhe platformat online mund të ofrojnë produkte që nuk plotësojnë kërkesat ligjore ose janë të pasigurta dhe si rrjedhojë lind nevoja për rishikimin e ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” ku kontrolli dhe zgjidhja e ankesave online do të vendoset si kompetencë e ISHMT. Momentalisht ISHMT nuk ka infrastrukturë për kryerjen e inspektimeve në platforma online, media sociale të cilat shesin produkte online për shkak se zgjidhja e ankesave për blerjet online është e pamundur nëse ka mungesë të informacionit të tregtuesit si NIPT dhe adresë fizike. Gjatë periudhës Janar-Gusht 2024 ISHMT ka trajtuar 20 ankesa nga të cilat 12 ankesa janë bërë si pasojë e blerjeve online dhe në mungesë të të dhënave

të tregtarit si NIPT dhe adresë ku ushtrohet aktiviteti, gjithashtu në mungesë të aksesit në platformat online është e pamundur të kryhet inspektim dhe këto ankesa të zgjidhen. Gjithashtu në vazhdim nëse tregtia online do të jetë kompetencë e ISHMT do të nevojiten kapacitete të shtuara njerëzore, trajnimi i tyre në këtë fushë dhe gjithashtu sigurimi i software të cilat bëjnë të mundur aksesin e ISHMT në këto platforma.

Për pajisjet e aerosolit dhe pajisjet e gazit

- ISHMT ka paraqitur pranë MEKI probelmatika që lidhen me zbatueshmërinë e Vendim nr. 925, datë 25.11.2020 Për miratimin e rregullit teknik “ Për pajisjet e aerosolit” dhe projekt VKM “Për pajisjet e gazit” që përafrojnë rregulloren GAR, i ardhur për konsultim publik.

Për pronësinë intelektuale

- Mungesa e akteve nënligjore në lidhje me disa nga fushat për të cilat Sektori i të Drejtave të Autorit realizon inspektime, e vështirëson procedurën e inspektimit dhe lë hapësirë për interpretime të ndryshme për të njëjtën çështje siç është për shembull transmetimi në publik i veprave audio-vizuale dhe kontrolli i programeve kompjuterike (aksesimi në këto programe gjatë realizimit të inspektimit).
- Të bëhen ndryshime në ligjin aktual të pronësisë industriale.(Ky variant mund të shkaktojë vonesë në zbatimin e ligjit si dhe kërkohet koordinim dhe dakordësim me DPPI në kuadër të ndryshimeve ligjore që DPPI aktualisht ka ndërmarrë, parashikohet të përfundojë në fund të vitit 2024)

Për rregulloren e brendshme të ISHMT

ISHMT-ja ka përgatitur Rregulloren e Brendshme të institucionit dhe e ka dërguar për miratim pranë Ministrisë, ku parashikohet një proces pune më i organizuar, eficient duke përfshirë një rishikim/shtim në detyrat funksionale të nëpunësve.

Nevoja për trajnime dhe fushata sensibilizuese

Përmirësimi dhe miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe Pronësisë Intelektuale ka sjellë zgjerim të fushë veprimtarisë së ISHMT dhe kjo shtrou nevojën për trajnime të vazhdueshme për fusha të reja si për aeroplanët pa pilot, kimikatet, pajisjet aerosol, programet kompjuterike, etj.

Informimi i konsumatorëve dhe operatorëve ekonomik në lidhje me kërkesat ligjore që shtrou legjislacioni dhe procesi i integritimit Europian kërkou ndërmarrje të fushatave sensibilizuese dhe informuese.

Nevoja për ndryshime proceduriale

- Lehtësim procedure prokurimi për produktet që duhet t’i nënshtrohen analizave laboratorike në laboratorë të huaj, duke patur në konsideratë që në Shqipëri ekziston vetëm një laborator i

akredituar për analizat e tekstilit dhe lëkurës, ndërsa për produkte të tjera që janë në fokusin e inspektimit të ISHMT-së si: lodra, detergjentë, produkte të kujdesit për fëmijë, etj., analizat duhet të kryhen në laboratore të akredituar të huaj. Kjo procedurë do të ndihmojë që përgjigjet e testeve të produkteve joushimore nga laboratorët e akredituar të mos i tejkalojnë afatet ligjore për marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit.

- Në kuadër të bashkëpunimit dhe raportimit të përbashkët në vendet e rajonit dhe me gjerë, bëhet e nevojshme përdorimi i kiteve/pajisjeve për vlerësimin e sigurisë së produkteve të hedhura në treg, dhe kjo shtron nevojën për rritjen e numrit të kiteve/pajisjeve/testeve nga inspektorët gjatë procesit të inspektimit si dhe nevojën për trajnime më të avancuara për përdorimin e tyre.
- Implementimi i procesit të regjistrimit të ashensorëve nëpërmjet portalit *e-albania* do të sjell lehtësim të subjekteve, personave në dorëzimin e dokumentave përkatëse dhe në pajisjen me certifikatën e regjistrimit të ashensorit nga ISHMT.

Mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB

Mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB, ka sjellë që shumë inspektime të mos kryhen sepse subjektet nuk gjenden nga inspektorët në adresat që ata kanë deklaruar në QKB. Kontaktet janë të paarrtshme dhe shumë subjekte që rezultojnë në databaza të institucioneve si DPD dhe DPT si aktive, pra si importues apo tatimpagues aktiv, në terren nuk evidentohen sipas adresave të deklaruara. Gjithashtu deklarimi i objektit të veprimtarisë së subjekteve në mënyrë fiktive në QKB është një problematikë e hasur.

VIII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Rekomandimet janë ngushtësisht të lidhura me sfidat e ndeshura gjatë vitit 2024. Ndaj si rekomandime kryesore mund të përmendim:

- ✓ **Fuqizimi i Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut**, në logjistikë, burime njerëzore, mjete transporti, buxhet, dixhitalizim të procedurave administrative, kite/pajisje/teste etj
- ✓ **Inicimi dhe kontribuimi në hartimin e një procedure** për kryerjen e analizave laboratorike në laboratorë të huaj të akredituar për produkte për të cilat nuk ka laboratorë të tillë në Shqipëri.
- ✓ **Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional** që do t'i shërbejë punës dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe aksioneve në mbrojtjen e konsumatorit, si dhe në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të sigurta dhe cilësore.

- ✓ **Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore të ISHMT-së** nëpërmjet trajnimeve, seminareve, workshopeve, vizitave studimore, duke synuar rritjen e shkallës së profesionalizmit dhe implementimin e metodave bashkëkohore në fushën e inspektimit, veçanërisht për sigurinë e produkteve joushqimore.
- ✓ **Rritja e aksesit të subjekteve ndaj informacionit** për detyrimet që duhet të plotësojnë në zbatim të legjislacionit ekzistues sipas fushave specifike që janë në fokusin e ISHMT-së.
- ✓ **Rritja e aksesit të konsumatorit ndaj informacionit** mbi sigurinë e produkteve joushqimore duke e bërë pjesëmarrës në rritjen e cilësisë së shërbimeve.
- ✓ **Fuqizimi i bashkëpunimit me strukturat homologe të vendeve të Rajonit** në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

IX. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025

Për vitin 2025 prioritetet e punës së ISHMT-së do të jenë:

Kontrolli i respektimit të kriterëve ligjore (Inspektimet)

Fokusi kryesor do të jetë në: A) grup-produktet që kanë rezultuar me problematika të ndryshme në vitet paraardhëse, që kanë një ndjeshmëri në treg si p.sh instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, parapaketimi, dekodera, karikues, llamba, etj, regjistrimi i ashensorëve në ISHMT, produkte për të cilat deri tani, nuk ka patur veprimtari mbikëqyrëse si: kimikate, artikujt aerosol, enët e thjeshta nën presion, pajisjet e gazit, artikujt piroteknik, etj.; B) respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në vitin 2025 do të realizohen në total **2438 inspektime nga të cilat 1950 të programuara dhe 488 të pa programuara**. 1362 inspektime të programuara dhe 340 të pa programuara në fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve joushqimore dhe 589 inspektime të programuara dhe 147 të pa programuara në fushën e pronësisë intelektuale.

Nr.	ISHMT	Numër inspektimesh total	Nr inspektimesh të programuara
1	Drejtoria e Produkteve Joushqimore	1702	1362
1.1	Sektori i Produkteve mekanike	368	294
1.2	Sektori i Produkteve Elektrike	276	221
1.3	Sektori Kimik dhe Siguria e Përgjithshme	368	294
1.4	Sektori i Inspektimit Metrologjik	690	552

2	Drejtoria e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale	736	582
2.1	Sektor i Pronësisë Industriale	276	221
2.2	Sektori i të Drejtës së Autorit	460	368
	TOTALI	2580	2064

Zbatimi i procedurave të inspektimit me korrektësi

- Kryerja e inspektimeve me tablet nga të gjithë inspektorët;
- Implementimi i programit i protokoll matjeve për parapaketimet (Program në EXCEL) në sistemin e-inspektimi duke evituar përdorimin e kiteve;
- Kryerja e inspektimeve me njoftim me njoftim paraprak të subjektit me përjashtim të inspektimeve të atyre fushave i cili mund të çënojë mbarëvajtjen e procesit, dhe kjo do të jetë e shoqëruar më një informacion bazuar në ligjet e posacme brenda fushë veprimtarisë së ISHMT-së.

Informimi

- Informimi i operatorëve ekonomikë për zbatimin e kriterëve ligjore mbi sigurinë e produkteve joushqimore si dhe mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbi sigurinë e produkteve dhe mbi të drejtat e tyre si konsumator.

Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore

- Trajnime të vazhdueshme të stafit për rritjen e shkallës së njohurive në fushat përkatëse.
- Në kuadër të projektligjit “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nevojës për shtimin e kapaciteteve institucionale të ISHMT referuar rekomandimeve të BE, ISHMT ka hartuar një strukturë të re e cila rrit ndjeshëm numrin e stafit dhe shton strukturat institucionale në krahasim me parashikimet e Urdhër nr. 73, datë 01.06.2020 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, ku struktura aktuale e institucionit përbëhet nga 4 njësi organizative (Drejtori), 8 njësi organizative (Sektorë) dhe me 80 punonjës në total. Me strukturën e re që do t’i propozohet Inspektoratit Qendror struktura e ISHMT ndryshon në 5 njësi organizative (Drejtori), 14 njësi organizative (Sektorë) dhe 89 punonjës në total. Gjithashtu parashikohet edhe ngritja e strukturave rajonale të ISHMT ku secila do të ketë përbëhet nga 3 njësi organizative (Drejtori), 5 njësi organizative (Sektorë) dhe me 39 punonjës në total.

Bashkëpunimet ndërinstitucional dhe Rajonal

- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të pronësisë intelektuale.
- Fuqizimi i bashkëpunimit të ISHMT-së me Autoritetet e Mbikëqyrjes së Tregut të vendeve të Rajonit për shkëmbim eksperience dhe të përvojave më të mira.

X. ANEKS

Tabela 1: Indikatorët mbi procesin e inspektimit

Nr.	Treguesit e vlerësimit të veprimtarisë inspektuese	Përqindja (%) e peshës specifike për çdo tregues	Kritere të vlerësimit të treguesit	Realizimi	Përqindja	Përqindja e peshës specifike e ndëruar	Përqindja e peshës specifike	Vlerësimi 1	Vlerësimi 2	Vlerësimi 3	Vlerësimi 4
1	Inspektime të programuara	15	numri i inspektimeve të kryera brenda programit (numri i inspektimeve të kryera jashtë programit)/numri i inspektimeve të kryera gjithsej	93.7	0.937	14.060	14.30	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
2	Inspektime të autorizuara	9	numri i autorizimeve me programim (numri i autorizimeve jashtë programit)/numri i autorizimeve të gjeneruara	93.7	0.937	8.436	8.60	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
3	Njoftimi i inspektimeve	9	numri i inspektimeve të njoftuara (numri i inspektimeve të panjoftuara)/numri i inspektimeve të kryera gjithsej	32.9	0.329	2.963	1.34	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
4	Kohëzgjatja e inspektimit	7	numri i inspektimeve për të cilat është kërkuar shtyrje e kohëzgjatjes së tyre apo atyre që kalojnë kohën maksimale të inspektimit në subjekt/ numri i përgjithshëm të inspektimeve	0.8	0.008	0.056	0.04	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
5	Rezultati nga marrje mostre	7	numri i shkeljeve të kërkesave ligjore të konstatuara nga analiza e mostrave/numri i mostrave të marra	-	-	-	-	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
6	Masat urgjente të marra	8	numri i masave urgjente/numri i procesverbaleve të inspektimit	0.1	0.001	0.008	0.01	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
7	Revokimet nga ankimet administrative	4	numri i vendimeve të revokuara/ numri i ankimeve administrative gjithsej	4.2	0.042	0.167	1.23	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
8	Revokime nga vendime të gjykatës	4	numri i vendimeve të rëzuara/numri i ankimeve gjyqësore gjithsej	9.1	0.091	0.364	(11.00)	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
9	Dënime administrative të vendosura	4	numri i dënimeve administrative të vendosura (ndjekje penale)/ numri i procesverbaleve të inspektimit	3.7	0.037	0.146	0.30	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
10	Shkelje e procedurës së inspektimit	10	numri i revokimeve për shkak të shkelesës së procedurës së inspektimit/numri i ankimeve gjithsej	-	-	-	10.00	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
11	Respektimi i vendit të inspektimit	3	numri i inspektimeve të kryera jo në vendin e përcaktuar në autorizim/ numri i inspektimeve gjithsej	-	-	-	3.00	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
12	Dënime administrative të ekzekutuara	2	numri i dënimeve administrative kryesore apo plotësuese të ekzekutuara/ numri i dënimeve administrative gjithsej	22.9	0.229	0.459	0.32	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
13	Numri i inspektimeve të kryera	2	numri i inspektimeve të kryera/ numri i inspektimeve të planifikuara	93.7	0.937	1.875	2.00	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
14	Dënime administrative gjopa në vlerë absolute	2	shuma absolute e gjobave/ të ardhura gjithsej	144.5	1.445	2.891	6.00	≤ 20%	20-50%	50-80%	80-100%
15	Rregullsia e dokumentimit të procesit të inspektimit	10	numri i inspektimeve me shkelje të ndëshkuara me ecuri disiplinore për inspektorët/ numri i inspektimeve gjithsej	-	-	-	10.00	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
16	Etika dhe sjellja e inspektorëve shtetërorë	4	numri i inspektorëve me shkelje të etikës/numri i inspektorëve gjithsej	-	-	-	4.00	80-100%	50-80%	20-50%	≤ 20%
	Treguesit specifikë e vlerësimit të veprimtarisë inspektuese										

1	Treguesi i objektivit strategjik apo vjetor I	Kriteri i matshëm i vlerësimit				50.14				
	Treguesi i objektivit strategjik apo vjetor II	Kriteri i matshëm i vlerësimit								

Tab.2: Të dhëna mbi inspektimet sipas fushë veprimtarive të ISHMT-së, viti 2024

Sektori/grup produktet	Numër inspekt. në total	Nr inspekt. të programuara	Nr.inspektimesh të paprogramuara	Gjoba	Paralajmërim	Masa Urgjente	Masa administrative total	Numër produktesh të	Numër produktesh jo në konformitet
Sektori I Inspektimit Metrologjik	997	962	35	14			14	3067	22
Parapaketim	895	882	13	2			2	1158	2
Instrumenta matëse në përdorim	64	52	12	5			5	1774	13
Instrumenta matëse që hidhen në treg	28	28						125	
Qese	10		10	7			7	10	7
Sektori I Produkteve Elektrike	484	420	64	9			9	906	9
Sektori I Produkteve Mekanike	280	272	8	18	1	3	22	673	84
Ashensore	215	207	8	15	1	3	19	486	72
PMP	10	10						41	
Makineri	31	21		2			2	88	9
Enët e thjeshta në presion	1	1						2	
Pajisjet e gazit	23	23		1			1	56	3
Sektori Kimik dhe Sig. Përgjithshme	472	457	15	11	1		12	4038	3
Lodra	43	42	1	1			1	279	3
Mbrojtja e konsumatorit	114	107	7	9			9	1344	
Siguria e përgjithshme	38	36	2		1		1	181	
Detergjente	113	111	2					956	
Tekstil	114	112	2	1			1	388	
Veshje këmbë	47	46	1					487	
Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve	2233	2111	122	52	2	3	57	8684	118
Sektori i të Drejtave të Autorit	343	340	3	37	3		40		
Programe kompjuterike	305	303	2	36	3		39		
Shtepi botuese, fotokopje, librari	38	37	1	1			1		
Vepra audio-vizuale									
Inspektim OSHMA(Radio+Kabllor)									
Sektori I Pronësisë Industriale	407	345	62	12			12		
Drejtoria e Pronësisë Intelektuale	750	685	65	49	3		52		
TOTALI	2983	2796	187	101	5	3	109	8684	118

Tabela 3: Realizimi i Planit të inspektimeve sipas sektorëve, viti 2024

Sektori/grup produktet	Numër inspektimesh Planifikuar	Inspektime realizuar	%
Sektori I Inspektimit Metrologjik	1226	997	81%
Sektori I Produkteve Elektrike	533	484	90%
Sektori I Produkteve Mekanike	347	280	80%
Sektori Kimik dhe Sig. Përgjithshme	650	472	72%
Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve	2756	2233	81%
Sektori i të Drejtave të Autorit	633	343	54%
Sektori i Pronësisë Industriale	522	407	77%
Drejtoria e Pronësisë Intelektuale	1155	750	64%
TOTALI	3911	2983	76%